



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpcës
Municipality of Strpce

Në përputhje me nenin 12, paragrafi 2, pika c. Ligji Nr. 03 / L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e RK" Nr. 28/2008), Neni 17 i Ligjit Nr. 03 / L-048 për Menaxhimin dhe përgjegjësitë për punën në financat publike ("Gazeta Zyrtare e RK" Nr. 27/2008) me ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit Nr. 03 / L-221, Ligjit Nr. 04 / Z-116, Ligjit Nr. 04 / L-194, Ligjit Nr. 05 / L-063, Ligjit Nr. 05 / L-007 ("Gazeta Zyrtare e RK" Nr.76 / 2010, 20/2012, 28/2013,1/2016, 13/2016), neni 36, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr. 01/2013 / MF shpenzimet parave publike, Neni 2 i Rregullores MF-Nr-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve, dhe nenit 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpcës nr.01/898 të datës 14.07.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2020, miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E RREGULLORËS NR.01-020/08-3342/17 PER
KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SE SUBVENCIONEVE**

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores per Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes se Subvencioneve NR.01-020/08-3342/17 te datës 03.07.2017

Neni 2

Pas nenit 2 të rregullores bazike shtohet **nenet** e reja emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

Neni 2A

E drejta për të marrë subvencione mund të përfitojnë vetëm persona fizikë me vendbanimi në komunën e Shtërpcës dhe personat juridikë (OJQ) të regjistruar me selinë në komunën e Shtërpcës.

Neni 3

Pas nenit 4 të rregullores bazike shtohet **nenet** e reja emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

Neni 4 A

Ndarja e subvencioneve për organizatat joqeveritare (OJQ)

1. Dhënia e subvencioneve për organizatat joqeveritare (OJQ) nga komuna e Shtërpcë kryhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me dispozitat e Rregullores MF-Nr-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve.

2. Një organizatë joqeveritare (OJQ) mund të jetë përfituese vetëm një herë në vit të subvencioneve të dhëna nga komuna, duke mos e llogaritur shumë aktivitete brenda një projektit
3. Nëse përfituesi nuk e përdor subvencionin për qëllimin e synuar dhe në përputhje me kontratën, ai i humb të drejtën për të marrë subvencione për secilën fushë për një periudhë prej dy (2) vitesh.

Neni 4

Rregullorja e Punës hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga kryesuesi i kuvendit.

KRYESUESI I KUVENDIT

Predrag Grbic

